| NR | DATA | KERKUESI | KERKESA | PERGJIJGA | DATA | Mënyra e përfundimit të kërkesës | Tarifa |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **SHKURT 2026** | | | | | | | |
| 1 | 02 | New Gen Shpk | informacion statistikor për importet e vincave (pajisje ngritëse për materiale) në Shqipëri për periudhën **2021-2025.**<br>1. **Numrin e njësiteve të importuara** sipas llojeve të vincave (elektrik, manual, overhead, portual etj.)<br>2. **Vlerën e importeve** në EUR<br>3. **Peshën totale të importeve**, nëse është e disponueshme<br>4. **Vendet e origjinës së importeve**<br>5. **Kodet tarifore HS të përdorura për secilin lloj vincash**, si p.sh.:<br>8425.20 – Hoist manual / elektrik i vogël<br>8425.39 – Vincë elektromekanike për materiale (jo për njerëz)<br>8426.11 – Vincë mobil / portual<br>8426.19 – Sisteme ngritjeje industriale<br>8426.49 – Vincë të tjera për materialet | Pergjigje 1 | 06 | E plote | Nuk ka |
| 2 | 02 | News 24 | Kerkese per:<br>1. sasia ne peshe dhe vlere - lista e operatoreve - vendet e origjines per produktin sipas NMK 0402 10 | Pergjigje 2 | 10 | E plote | Nuk ka |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | 2. sasia ne peshe dhe vlere- lista e operatoreve - vendiet e origjines per produktin sipas NMK 0402 21<br>3. sasia ne peshe dhe vlere- lista e operatoreve - vendet e origjines per produktin sipas NMK 0402 29 | | | | |
| 3 | 15 | Report TV | 1- Sa qumësht pluhur është importuar nga jashtë nga viti 2020-2025 si dhe për<br>periudhën janar 2026?<br>2- Nga cilat shtetet është importuar më shumë qumësht pluhur?<br>3- Sa kompani shqiptare importojnë qumësht pluhur?<br>4- Me çfarë çmimi është zhdoganuar në Doganë qumështi pluhur për këto periudha?<br>5- Sa është vlera e taksave doganore të arkëtuara nga importi i këtij produkti | | 19 | E plote | Nuk ka |
| 4 | 17 | Rrjeti per Raportimin e Krimit te Organizuar dhe Korrupsionit<br><br>Shteg.org | 1. Kerkese per listë të operatorëve ekonomikë që kanë kryer eksport druri.<br>2. Një listë me tregjet kryesore të destinacionit për drurin e eksportuar.<br>3. Një dokument që tregon sasinë totale të drurit të eksportuar nga Shqipëria gjatë 5 viteve të fundit.<br>4. A ka pasur raste të ndërprerjes së eksportit ose sekuestrimit të drurit për shkak të shkeljeve ligjore? | Pergjigje 4 | 04 Mars | E plote | Nuk ka |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | Nëse po, ju lutem referoni numrin e rasteve dhe operatorët që kanë kryer këtë veprimtari.<br>5. A ekziston një sistem gjurmimi i origjinës së drurit që eksportuesit duhet të përdorin<br>7. Një listë të referimeve për ndjekje penale ndaj eksportuesve të drurit të paligjshëm. | | | | |
| 5 | 17 | Emisioni Vetting | 1. A keni kryer analiza për praninë e aflatoksinave dhe OTA në drithërat e importuara dhe të eksportuara përgjatë periudhës kohore 2014-2025? Nëse po, kërkojmë një kopje të këtij raporti.<br>2. Kërkojmë një kopje të raportit në lidhje me numrin e rasteve të refuzimit ose të bllokimit të ngarkesave për shkak të tejkalimit të niveleve maksimale të lejuara përgjatë periudhës kohore 2014-2025.<br>3. A keni patur njoftime në sistemin RASFF që lidhen me produkte shqiptare të kontaminuara me aflatoksina, përgjatë periudhës kohore 2014-2025? Nëse po, kërkojmë një kopje të këtij raporti. | lidhur me kerkesen mbi analizat për praninë e aflatoksinave dhe OTA në drithërat e importuara dhe të eksportuara përgjatë periudhës kohore 2014-2025, ju bejme me dije se autoriteti doganor, nuk eshte ne zoterim te nje informacion te tille.<br><br>Per sa me siper ju duhet ti drejtoheni autoritetit kombetar te ushqimit dhe degeve/inspektoriateve, etj ne varesi te tyre, te cilat kane ne fushen e veprimtarise kontrollin/llet mbi eksportin dhe importin e mallrave sipas fushës së | 10 mars | E plote | Nuk ka |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | përgjegjësisë që u njeh legjislacioni vendas. | | | |
| 6 | 18 | Ora News | Kerkese lidhur me njoftimin mbi bllokimin e disa mallrave nga DD Durres.<br>Cili është emri i subjektit tregëtar dhe statusi aktual i autorizimit të tij?<br>Malli i skaduar ka hyrë në proces përpunimi apo ka qenë ende i papërdorur në magazinë?<br>Çfarë masash administrative janë marrë ndaj subjektit?<br>Sa është vlera financiare e mallit të bllokuar? | Lidhur me blokimin e mallit nga DD Durrës, perkundrejt procedures se perpunimit aktiv, materialet e gjeneruara nga autoritetit doganor i jane kaluar per veprime te metejshme proceduriale autoriteteve te tjera ne zbatim te Kodit Doganor dhe Kodit te Procedurave Administrative lidhur me procedurat verifikuese dhe vendimmarrjen sipas rastit. | 10 mars | E plote | Nuk ka |
| 7 | 19 | Qytetar | **Ankim per Blerje Online**<br>Une XXXX paraqes këtë ankesë administrative lidhur me procedurën e ndjekur nga autoriteti doganor për një dërgesë të porositur online nga Kina, për të cilën është aplikuar një rivlerësim i pajustifikuar dhe në kundërshtim me Kodin Doganor të Republikës së Shqipërisë.<br><br>Artikulli i pare (me nr. reference RE050035271NL)në fjalë është blerë me vlerë 70.21 USD, fakt i provuar | Posta Shqiptare per zhdoganimin e objekteve postare, operon bazuar ne VKM 651 “Per Dispozitat e Kodit Doganor” date 10.11.2017 dhe Udhezimin nr.2 dt. 15.01.2018 te Drejtorise se Pergjithshme te Doganeve. | 20 | E plote | Nuk ka |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | përmes dokumentacionit përkatës (faturë / konfirmim pagese). Megjithatë, autoriteti doganor ka shtuar në mënyrë arbitrare një shumë prej 20 USD si kosto transporti, ndonëse kjo kosto nuk është e specifikuar, e faturuar dhe as e ndarë veçmas nga shitësi, dhe nuk rezulton në dokumentet shoqëruese të mallrave.<br><br>Artikulli i dyte (ne reference RE050035648NL) në fjalë është blerë me vlerë 65.89 USD, fakt i provuar përmes dokumentacionit përkatës (faturë / konfirmim pagese). Megjithatë, autoriteti doganor ka shtuar në mënyrë arbitrare një shumë prej 20 USD si kosto transporti, ndonëse kjo kosto nuk është e specifikuar,<br>e faturuar dhe as e ndarë veçmas nga shitësi, dhe nuk rezulton në dokumentet shoqëruese të mallrave.<br><br>Si pasojë e këtij rivlerësimi të padrejtë, autoriteti doganor ka llogaritur dhe mbajtur taksa doganore mbi një vlerë totale prej 90.21 USD ne rastin e pare dhe 85.89 USD ne rastin e dyte duke më shkaktuar një dëm ekonomik të pajustifikuar dhe në kundërshtim me legjislacionin në fuqi. | Ky zhdoganim behet ne baze te ketij Udhezimi ne Modulin e Assycuda me ane te deklarates se thjeshtuar.<br><br>Si baze per Vleren Doganore sherben deklarata doganore qe ne dokumentat e Postes njihet si formulari CN 22 dhe CN 23 duke i mbledhur me shpenzimet e transportit bazuar ne VKM 651 neni 159.<br>Ne rastet kur vlera e transportit nuk pershkruhet, i referohemi tabeles se cmimeve referuese ne baze te shkreses nr. 2951/1 dt. 21.03.2014 te miratuar nga Ministria e Transportit si dhe shteses se udhezimit nr 2 me nr 5139/1 prot date 01.03.2019.<br>Pra si shembull: Vlera doganore= vlera e objektit postare + vlera e transportit.<br>Dmth nese nje objekt eshte blere me vlere 150 | | | |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | Në bazë të Kodit Doganor të Republikës së Shqipërisë, si dhe akteve nënligjore në zbatim të tij, vlera doganore duhet të përcaktohet mbi bazën e vlerës së transaksionit real, pra çmimit të paguar ose të pagueshëm për mallin, dhe çdo shtesë (përfshirë transportin) duhet të jetë e provuar, e dokumentuar dhe e justifikuar. Shtimi i një vlere transporti pa u bazuar ne dokumente bie ndesh me parimet e ligjshmërise dhe transparencës.<br><br>Si pasojë e këtij rivlerësimi të padrejtë, dogana ka aplikuar taksa doganore mbi një total prej 90 dollarësh, duke më shkaktuar një dëm ekonomik të pajustifikuar.<br><br>Për sa më sipër, kërkoj:<br>- Rishqyrtimin e çështjes dhe rivlerësimin e vlerës doganore bazuar vetëm në çmimin real të transaksionit prej 70.21 USD dhe 65.89 USD;<br>- Anulimin e shtesës arbitrare të kostos së transportit;<br>- Korrigjimin e taksës doganore dhe, nëse është e aplikueshme, rimbursimin e shumës së mbajtur padrejtësisht; | USD, shpenzimi i transportit postar eshte 100 USD atehere totali i vleres doganore mbi te cilin do te aplikohet dogana eshte 250 USD<br><br>**Per pakon me barkod RE050035271NL**<br>Vlera e pakos 70.21 $ + 20 $(vlera e transportit) =**90.21 $ Vlera Total**<br><br>Vlera total 90.21 $ x 83.48 (kursi i $) x 20% (tvsh**) = 1506 leke detyrimi doganor**<br><br>**Tarifa 500 leke eshte detyrimi per prerjen e deklarates se thjeshtuar.**<br><br>**Per pakon me barkod RE050035648NL**<br>Vlera e pakos 65.89 $ + 20 $(vlera e transportit) =**85.89 $ Vlera Total**<br>Vlera total 85.89 $ x 83.48 (kursi i $) x 20% | | | |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | (tvsh) **= 1434 leke detyrimi doganor**<br><br>**Tarifa 500 leke eshte detyrimi per prerjen e deklarates se thjeshtuar.** | | | |
| 8 | 23 | Monitor | Kerkese per të dhënat e Importeve në vlerë dhe sasi për muajt<br>Janar - dhjetor viti 2025<br>Makarona/Oriz/Grurë/Misër/Qumësht<br>Qumësht Pluhur/Birrë (import+prodhim)<br>Vaj ulliri (import + eksport) | Pergjigje 8 | 25 | E plote | Nuk ka |